



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARIMIT PRIVAT
PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT ELVIN HOXHA
CERTIFIKATE NR.206/JANAR 2015 NIPT.L42109004H

Adresa: Rruga "Vaso Pasha" Nr.13/1, Ap.1, Tirane

E-mail: elvinth@hotmail.com Mob: +355682029920



Nr.130/17

Nr. IGI Prot.

Tiranë më datë 13/3 /2017

URDHËR

(PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE)

Drejtuar : QËNDRËS KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT

Per Dijeni : Debitorit , Shoqëria "EKSPRES-BETON LEZHË" shpk Nr.(NIPT) K58515501V
Kreditorit, Shoqëria "SEGMENT" sh.p.k.

Prane meje Permbaruesit Gjyqësor Privat Elvin Hoxha eshte depozituar kerkesa e pales kreditore Shoqëria "SEGMENT" sh.p.k. sëbashku me Vendimin për lëshimin e Urdhër Ekzekutimi Nr.130 datë 21.02.2017 lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me palë:

-Kreditor: Shoqëria "SEGMENT" sh.p.k.

-Debitor: Shoqëria "EKSPRES-BETON LEZHË" shpk Nr.(NIPT) K58515501V

Me Vendimin për lëshimin e Urdhër Ekzekutimi Nr.130 datë 21.02.2017 lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, është vendosur :

1. Pranimi I kerkeses
2. Leshimi I Urdherit te Ekzekutimit per faturën tatimore të shitjes me numër 151, nr.serial 10131951 datë 02/04/2014.
3. Ngarkohet Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor për ekzekutimin e titullit ekzekutiv

Ne kushtet kur per ekzekutimin e Urdhër Ekzekutimi Nr.130 datë 21.02.2017 lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, nuk eshte permbushur detyrimi ne menyre vullnetare , nga ana e Permbaruesit Gjyqësor Privat duhet te kryhet vendosja e mases se sekuestros konservative ne kuotat/aksionet e pales debitore Shoqëria "EKSPRES-BETON LEZHË" shpk Nr.(NIPT) K58515501V

Si në zbatim të neneve 527 e në vijim të K.Pr.Civile dhe ligjit nr.10031 , datë 11.12.2008 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat"

URDHEROJ :

1-Vendosjen e mases se sekuestros konservative ne kuotat/aksionet e pales debitore Shoqëria "EKSPRES-BETON LEZHË" shpk Nr.(NIPT) K58515501V , si dhe mbi te drejtat qe rrjedhin nga zoterimi i ketyre kuotave duke ndaluar tjetersimin dhe/ose disponimin e tyre si dhe mos kryerjen e asnje




veprimi tjetër i cili mund të ndryshojë të dhënat në regjistrin tregtar. Dokumentacioni do të qendrojë i bllokuar deri në një urdher të dytë nga Përmbartuesi Gjyqësor Elvin Hoxha .

Debitori : Shoqëria "EKSPRES-BETON LEZHË" shpk Nr.(NIPT) K58515501V me adresë të ushtrimit të aktivitetit : Marktomaj , Zejmen , Lezhë

- 2- Për veprimet apo mos veprimet tuaja duhet të na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor
- 3- Personat që behen pengesë , do të përgjigjen në bazë të nenit 606 K.Pr.Civile (paragrafi II) që parashikon vendosjen e sanksionit të gjobes dhe kallezimit penal.
- 4- Ky urdher mbahet në disa kopje dhe u njoftohet paleve të cilat kanë të drejtën e ankimit në Gjykatë brenda 5 (pese) diteve.

**PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT
ELVIN HOXHA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR LEZHË

Nr.130(11233-00251-53-2017) Regj. Themeltar
Data e regjistrimit, 13.02.2017.

Nr 130 Vendimit
Datë 21.02.2017.

VENDIM
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë e përbërë prej:

GJYQTAR - ARTAN HAJREDINAJ

asistuar prej sekretare gjyqësore Drita Suta, sot më datë 21.02.2017, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, çështjen civile me Nr. 130 akti, që i përket:

KËRKUES:

Shoqeria "SEGMENT" sh.p.k, me Administratore znj. Ajten Goci, e regjistruar me Nipt L21916035A, me adrese: Autostrada Tirane - Durres, KM 7, nr.1051, Tirane.

OBJEKTI:

Leshimin e urdherit te ekzekutimit per titullin ekzekutiv faturen tatimore te shitjes: nr.151, nr. serial 10131951 date 02/04/2014.

BAZA LIGJORE:

Nenet 510/e, 511/d te Kodit te Procedures Civile, si dhe Nenet 4, 5, 6, 11, 12, 16 te Ligjit nr.48/2014 "Per pagesat e vonuara ne detyrimet kontraktore e tregtare" dhe ligji nr.9920, date: 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise" (i ndryshuar).

Gjykata, në përfundim të hetimit gjyqësor, pasi administroi aktet dhe pasi shqyrtoi në tërësi rrethanat e çështjes,

VËREN:

Se, pala kerkuese i eshte drejtuar Gjykates me nje kerkese sipas objektit te percaktuar ne pjesen hyrese te ketij vendimi.

Gjykata ne referim te nenit 3 te Ligjit Nr. 114/2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996, "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar ne te cilin parashikohet se: "Shqyrtimi i kërkesës për lëshimin e urdherit të ekzekutimit zhvillohet nga gjyqtari pa praninë e palëve"....., çmoi se nuk eshte e domosdoshme te thirret pala kerkuese ne kete gjykim.

Përpara shqyrtimit të bazueshmërisë në ligj e në prova të kërkesës, gjykata analizoi kryesisht juridiksionin dhe kompetencën e saj në gjykimin e kësaj çështje. Bazuar në nenet 36 paragrafi 1

dhe 59, 41 dhe 511 gërma ç të Kodit të Procedurës Civile, gjykata konstatoi se çështja civile hyn në juridiksionin gjyqësor civil dhe është në kompetencën lëndore e tokësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, si gjykatë e vendit ku është çaktuar të bëhet ekzekutimi.

Gjatë hetimit gjyqësor rezultoi se Shoqëria "SEGMENT" sh.p.k, me Administratore znj. Ajten Goci, ushtron aktivitet me objekt: "Tregti, Servis te pjeseve te kembimit per mjetet e renda etj". Gjate ushtrimit te aktivitetit te saj Shoqëria "SEGMENT" sh.p.k, i ka shitur pjese kembimi per makineri pune shoqërise "EKSPRES-BETON LEZHE" sh.p.k. e regjistruar me nr. NIPT K58515501V, me seli ne Lezhe, me adrese: Markatomaj, Zejmen, Lezhe. Sipas marrëdhënies tregtare te vendosur nga shitja e mallit shoqëria "SEGMENT" sh.p.k, ka leshuar per shoqërine "EKSPRES-BETON LEZHE" sh.p.k faturen tatimore te shitjes objekt kerkimi. Fatura tatimore e shitjes duhet te paguhet nga bleresi shoqëria "EKSPRES-BETON LEZHE" sh.p.k jo me vone se 30 dite pas dates se pranimit te fatures se shitjes se mallit. Malli eshte levruar duke u marre ne dorezim nga shoqëria "EKSPRES-BETON LEZHE" sh.p.k. pa asnje pretendim. Fatura eshte firmosur rregullisht nga te dy palet. Kjo fature e ka te percaktuar shumen e detyrimit monetar qe duhet te paguaje bleresi per mallin qe ka marre. Me gjithë perpjekjet e bera nga shoqëria "SEGMENT" sh.p.k per kerkimin e pagimit te detyrimit nuk eshte realizuar vjelja e detyrimit ne shumen e percaktuar ne faturen tatimore te shitjes. Ne kushtet kur nga ana e shoqërise debitore nuk eshte bere pagesa e fatures tatimore te shitjes objekt kerkimi, brenda afatit ligjor, pala kerkuese i eshte drejtuar gjykates me kerkimin per ekzekutimin e detyrueshem te shumes per faturen tatimore te shitjes nr.151, nr. serial 10131951 date 02/04/2014, ne ngarkim te pales debitore shoqërise "EKSPRES-BETON LEZHE" sh.p.k. duke e konsideruar ate si titull ekzekutiv.

Sipas nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile: "Ekzekutimi i detyrueshëm mund të bëhet vetëm në bazë të një titulli ekzekutiv. Janë tituj ekzekutivë: ...e) Aktet e tjera që sipas ligjeve të vecanta quhen tituj ekzekutivë dhe ngarkohet zyra e përmbartimit për ekzekutimin e tyre".

Neni 511: "Titulli ekzekutiv vihet në ekzekutim me kërkesën e kreditorit. Për këtë qëllim lëshohet urdhri i ekzekutimit, brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së kreditorit, i cili jepet : ...c) për rastet e prashikuara nga shkronjat : "d", "dh" dhe "e" nga gjykatat e vendit ku është çaktuar të bëhet ekzekutimi...."

Ligj nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare", neni 1: "Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për afatet dhe mënyrën e llogaritjes së kamatave ligjore për pagesat e vonuara, në rastet e furnizimit me mallra apo shërbime nga ana e ndërmarrjeve tregtare kundrejt ndërmarrjeve të tjera tregtare dhe autoriteteve publike, në mënyrë që të sigurohet funksionimi i duhur i tregut të brendshëm, duke nxitur aftësinë konkurruese të ndërmarrjeve tregtare dhe, në veçanti, të ndërmarrjeve të vogla e të mesme".

Neni 2: "Ky ligj zbatohet për të gjitha pagesat e kryera si kundërpaguesë për veprimet juridike tregtare. Nuk i nënshtrohen rregullimeve të këtij ligji detyrimet apo pagesat: a) që janë objekt i procedurës së falimentimit të çelur kundër debitorit, përfshirë edhe procedurën me objekt ristrukturimin e borxhit; b) që rrjedhin nga kontratat me konsumatorët; c) që lidhen me i nteresin apo pagesat e tjera të kryera për titujt; ç) që lidhen me shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor, përfshirë edhe pagesat e dëmeve nga shoqëritë e sigurimit."

Neni 16: "1. Detyrimet monetare, të lindura nga veprimet juridike tregtare, të cilat nuk janë shlyer brenda afatit të pagesës përkatëse, sipas këtij ligji, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 485 i Kodit Civil, përbëjnë titull ekzekutiv dhe vihen ne ekzekutim nga përmbartuesi gjyqësor, pavarësisht vlerës, kur: a) kreditori ka lëvruar mallrat apo kryer shërbimet sipas kontratës dhe ligjit; dhe b) debitori nuk e ka kundërshtuar detyrimin. 2. Në këto raste, detyrimi së bashku me kamatëvonesat dhe me shpërblimin për shpenzimet për rikthimin e

kredisë mund të vihen në ekzekutim të detyrueshëm, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile”.

Në interpretim të kërkesave të këtij ligji që një faturë të tatimore shitje të plotësoj kushtet e një titulli ekzekutiv duhet:

Marëdhëniet mes debitorit dhe kreditorit të jenë të karakterit tregtar a kontraktor konkretisht atë të furnizim me mallra a shërbime, kundër -pagesat për veprimet juridike tregtare etj. Edhe nëse janë në mardhënie furnizimi me mallra/ shërbime përjashtohen nga ky ligj veprimtaritë e parashikuar nga neni 2 i ligjit si: a) që janë objekt i procedurës së falimentimit të çelur kundër debitorit, përfshirë edhe procedurën me objekt ristrukturimin e borxhit; b) që rrjedhin nga kontratat me konsumatorët; c) që lidhen me interesin apo pagesat e tjera të kryera për titujt; ç) që lidhen me shpërblimin dëmit jashtëkontraktor, përfshirë edhe pagesat e dëmeve nga shoqëritë e sigurimit. Subjektet tregtare që kanë krijuar këto mardhënie duhet të jenë ndërmarrje tregtare kundrejt ndërmarrjeve të tjera tregtare dhe/ose autoriteteve publike.

Detyrimi është bërë i kërkueshëm sipas afateve të përcaktuar në ligj, pra brenda 30 ditë kalendarike të dorëzimit të mallit, transportit apo kur është marrë fatura tatimore etj.

Debitori nuk e ka kundërshtuar si detyrim.

Të mos jemi në asnjë nga rastet e parashikuar nga neni 485 të Kodit Civil.

Fatura tatimore të shitjes me numër 151, nr. serial 10131951 date 02/04/2014, plotëson të gjithë elementët e parashikuar në ligj për t'u konsideruar titull ekzekutiv. Prandaj, pas shqyrtimit të rrethanave të faktit dhe analizës juridike, gjykata arrin në përfundimin se kërkesa për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit e paraqitur nga kërkuesi “Shoqëria “SEGMENT” sh.p.k është e bazuar në ligj dhe në prova dhe si e tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata bazuar në nenet 510 dhe 511 të Kodit të Procedurës Civile dhe ligjin nr.48/2014,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për faturen tatimore të shitjes me numër 151, nr. serial 10131951 date 02/04/2014.
3. Ngarkohen Shërbimet Përmbarimore Gjyqësore për ekzekutimin e titullit ekzekutiv.
4. Shpezimet gjyqësore i ngarkohen kërkuetit.
5. Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankim.
6. Ky vendim hartohet vetëm në një kopje.

U shpall në Lezhë, sot më 21.02.2017.

SEKRETARE

Drita Suta

